

I. Përmbyllja e procedurave për zgjedhjen e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH)

- *8 nga 40 kandidatë në total kualifikohen për të vazhduar garën për pozicionin e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.*

[Ligji për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar](#), parashikon hapat specifike në funksion të zgjedhjes së Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH). Me [emërimin](#) e prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, filluan edhe procedurat respektive për zgjedhjen e Drejtorit të BKH.

Në faqen zyrtare të Byrosë Kombëtare të Hetimit u publikua në **10 janar 2020** [thirrja për Drejtor të BKH-së](#), afati i së cilës përfundoi në datën 30 janar 2020, ndërkohë që njoftimi parashikonte edhe [kriteret, kushtet ligjore dhe fazat e përgjedhjes](#) në përputhje me legjislacionin përkatës.

Pavarësisht afatit të aplikimeve, në datën **24 janar 2020**, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme [informoi](#) mbi numrin e aplikantëve për pozicionin e Drejtorit të BKH (5), duke nxitur në të njëjtën kohë aplikimin e kandidatëve të tjerë, të cilët demonstrojnë leadership, integritet dhe profesionalizëm.

Ndërkohë me përfundimin e afatit të aplikimeve në datën 30 janar 2020, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, [informoi](#) për numrin total të kandidatëve, të cilët aplikuan në fazën e parë të përzgjedhjes. Në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të institucionit, njoftohet që Komisioni i Përzgjedhjes, me datën 01.02.2020 mori në shqyrtim 40 aplikime (dosje) të dërguara nga kandidatët duke i vlerësuar ato në lidhje me plotësimin e kriterëve ligjore.

Kandidati për Drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit mund të jetë personi që ka vetëm shtetësi shqiptare, që gëzon cilësi të larta profesionale dhe morale, dhe plotëson kriteret më poshtë:

SPAK Info Nr. 15 trajton përmbushjen e hapave ligjorë në drejtim të zgjedhjes së Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) si edhe vendimit të KLGJ për kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Për shumë informacion mbi zbatimin në kohë të hapave ligjorë në drejtim të ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK mund të lexoni Buletinet 3-mujore SPAK Monitor të publikuara në faqen e CSDG: www.csdgalbania.org

Publikimet realizohen në kuadër të projektit “Monitorimi dhe vlerësimi i procesit të ngritjes dhe funksionimit të Gykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Strukturës së Posaçme SPAK, nëpërmjet hulumtimit, informimit, ndërgjegjësimin dhe mbështetjes në ngritjen e kapaciteteve administrative”, i mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

- a. ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë të barasvlershme me “Master i shkencave”, ose arsimin e lartë policor;
- b. ka eksperiencë pune si prokuror, punonjës i Policisë së Shtetit apo Policisë Gjyqësore ose hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit;
- c. ka përvojë pune të paktën 5 vjet në çështje që kanë të bëjnë me veprat penale në fushën e korrupsionit, krimit të organizuar apo krimeve të rënda;
- d. nëse ka qenë apo është punonjës i Policisë së Shtetit, të ketë mbajtur për jo më pak se 3 vjet gradën “Komisar”, “Kryekomisar”, “Drejtues” apo “Drejtues i Parë”;

si edhe të ketë dërguar deklaratat për dhënien e pëlqimit të tij dhe të anëtarëve të afërt të familjes për heqjen e dorë nga privatësia (dhënien e pëlqimit për kontroll periodik të llogarive bankare dhe telekomunikimeve vetjake).

Nga 40 kandidatët aplikantë në fazën e parë, Komisioni **përzgjedhi 18 kandidatë** për të vazhduar garën për pozicionin e Drejtorit të BKH. Ndërkohë pas vlerësimit të testit të aftësive fizike, testit të arsytimit logjik dhe të aftësive për të shkruajtur raporte dhe llogaritjes së pikëve totale për secilin kandidat, Komisioni i Përzgjedhjes për Drejtorin e BKH-së [vendosi](#) të kualifikojë 8 kandidatë për të marrë pjesë në fazat e mëtejshme të përzgjedhjes.


II. Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Funksionimi i Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar me më pak gjyqtarë se numri i parashikuar në legjislacionin (16 në shkallën e parë dhe 11 në apel), jo vetëm që ka qenë një [problematikë e risjellë në vëmendje](#), por ka paraqitur gjithashtu [vështirësi](#) në mbarvajtjen e zhvillimit të seancave gjyqësore dhe përbërjen e trupave gjyqësore të këtyre gjykatave.

Aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar [u emëruan](#) 12 gjyqtarë, ndërkohë që në Gjykatën e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar [u emëruan](#) vetëm 6 gjyqtarë. Pranimi nga ana e tyre për kufizimin e privatësisë, por në mënyrë të veçantë vendimet e institucioneve të rivlerësimit krijuan mosplotësimin e vendeve vakante në organet e gjyqësorit. Për më tepër numri i gjyqtarëve të emëruar në Gjykatat e Posaçme KKKO vazhdon të ulet si rezultat i shkarkimeve nga detyra, duke e bërë problematike funksionimin normal të këtyre institucioneve. Me konfirmimin në detyrë në të dyja shkallët, gjyqtarët e Gjykatave të Posaçme KKKO mund të emërohen në mënyrë të përhershme në këto institucione dhe ky proces është thelbësor edhe në drejtim të plotësimin të vendeve vakante në këto organe.

Në këtë kontekst, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në **mbledhjen e datës 7 shkurt 2020**, miratoi [vendimin](#) mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, duke hapur rrugë funksionimit të plotë të Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nëpërmjet shpalljes së vendeve

vakant, procedurës së ngritjes në detyrë dhe promovimit të gjyqtarëve profesionistë dhe me integritet të lartë.



* Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) (www.kpk.al)

I. Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatave të Posaçme KKKO

Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë KKKO					
		Seanca Dëgjimore	Vendimi i KPK	Vendimi i IKP	Vendimi i KPA
1.	Sandër Simoni	14.01.2020	Konfirmuar në detyrë		
2.	Ardit Mustafaj		Në proces rivlerësimi		
3.	Irena Gjoka		Në proces rivlerësimi		
4.	Daniela Shirka	07.11.2019	Konfirmuar në detyrë		
5.	Etleva Deda		Në proces rivlerësimi		
6.	Flora Hajredinaj		Në proces rivlerësimi		
7.	Fran Prendi		Në proces rivlerësimi		
8.	Ilirjana Olldashi	02.12.2019	Konfirmuar në detyrë		
9.	Marsela Balili	13.01.2020	Shkarkuar nga detyra		
10.	Bib Ndreca		Në proces rivlerësimi		
11.	Miliana Muça	31.01.2020	Konfirmuar në detyrë		
12.	Klodian Kurushi	05.12.2019	Konfirmuar në detyrë		
Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit KKKO					
1.	Nertina Kosova	17.07.2018	Konfirmuar në detyrë	Vendimi i KPK ankimuar në KPA	Konfirmuar nga KPA
2.	Nure Dreni		Në proces rivlerësimi		
3.	Saida Dollani	20.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
4.	Dhimitër Lara	27.05.2019	Konfirmuar në detyrë		
5.	Sokol Binaj	17.05.2019	Konfirmuar në detyrë		
6.	Albana Boksi	04.04.2019	Konfirmuar në detyrë		

* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 17 shkurt 2020

2. Statusi i vetting-ut për 14 kandidatët të cilët u renditën për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Statusi i vetting-ut për 15 kandidatët e renditur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar					
		Seanca Dëgjimore	Vendimi i KPK	Vendimi i IKP	Vendimi i KPA
1.	Altin Dumani	30.07.2019	Konfirmuar në detyrë		
2.	Anton Martini	10.12.2019/27.01.2020	Konfirmuar në detyrë		
3.	Elizabeta Imeraj		Në proces rivlerësimi		
4.	Arben Kraja	13.12.2018	Konfirmuar në detyrë		
5.	Doloreza Musabelliu	02.12.2019	Konfirmuar në detyrë		
6.	Klodjan Braho	25.07.2019	Konfirmuar në detyrë		
7.	Enkeleda Millonai	13.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
8.	Manjola Kajana	18.06.2019	Konfirmuar në detyrë	Vendimi i KPK ankimuar në KPA	Në proces
9.	Edvin Kondili	06.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
10.	Ened Nakuçi	06.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
11.	Elida Kaçkini	16.07.2019	Konfirmuar në detyrë		
12.	Ndini Tavani	07.10.2019	Shkarkuar nga KPK	Vendimi i KPK ankimuar në KPA	Në proces
13.	Behar Dibra	20.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
14.	Anita Jella	04.10.2019	Konfirmuar në detyrë		

* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 17 shkurt 2020